



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:240434

Datë: 28.07.2020

Numri i dokumentit: 01042208

**C.nr.1013/2019**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Skender Shala, ne çështjen juridike te paditësit: N [REDACTED] X [REDACTED] nga [REDACTED] të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. [REDACTED] sipas autorizimit me shkrim, kundër te paditurës: [REDACTED] të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson [REDACTED], për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar, pas mbajtjes se seancës kryesore publike me datë 20.07.2020, me dt. 28.07.2020 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N [REDACTED] X [REDACTED] nga [REDACTED] dhe

**II. OBLIGOHET** e paditura [REDACTED] në [REDACTED] t'ia paguajë paditësit N [REDACTED] X [REDACTED] në [REDACTED], në emër të pagesës së 2 pagave për shpërblim jubilar për periudhën e punës prej më shumë se 20 vite, shumën totale prej 926.56 €, të gjitha në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm

**III. OBLIGOHET** e paditura [REDACTED] në [REDACTED] t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 259.00 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi me datë 22.10.2019, e të precizuar ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale në emër të shpërblimit jubilar të dy (2) pagave jubilarë në lartësi prej 926.56 €, konform nenit 17.3 dhe 17.4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018.

Gjykata, me dt. 20.07.2020, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesja e të paditurës. Paditësi në seancë e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: mbetet në tërsi pranë padisë dhe kërkespadiisë së parashtruar, sa i përket pagesës së paditësit i njëjti pagën mujore deklaroi se e ka pasur në shumë

prej 463.28 euro. Më tutje vzhdon duke theksuar se te e padituranë momentin e ngritjes së padis ka mbi 20 vite përvojë pune pa ndërprerë, ashtu që kërkon kompensimin në vlerë të dy pagave bazë në shumë prej 926.56 euro. Hjek dorë nga kamata ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i kërkon dhe atë për përpilimin e padisë 104.00, për përfaqësim në një seanc shumë prej 135.00 euro, në emër të pagesës së taksës për padi shumë prej 20.00 euro.

E autorizuar e të paditurës në përgjigje të padisë dhe kërkesepadisë deklaroi: nuk e kundërshton bazën juridike të padisë dhe kërkesepadisë, ashtu si qëndron në përgjigjen e menagjmentit të të paditurës, në kërkesën e paditësit, të njëjtit nuk iu është paguar paga në emër të shpërblimit jubilar nga arsya e mungesës së mjeteve buxhetore në të kundërten është e vërtet se e paditësi tek e paditura ka përvojën e punës mbi 20 vite, po ashtu nuk e konteston as lartësin e pagës së paaditësit në shumë prej 462.28 euro, ku paditësi është duke vazhduar marrëdhënien e punës te e paditura. Shpenzimet e procedurës nuk i këkron.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 te LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: kërkesa e dt.11.10.2019, vendimi i dt.02.10.2019, vendimi i dt.15.10.2019, vërtetimi mbi përvojën e punës i dt.26.06.2020, pasqyra e pagës në emër të paditësit dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësi para ngritjes së padis ju ka drejtuar te paditurës me kërkesë për kompensimin e pagave jubilarë, fakt ky i cili vërtetohet nga kërkesa e dt.11.10.2019.

Për gjykatën nuk është kontestuese fakti se lidhur me kërkesën e paditësit e paditura ka nxjerr vendim me të cilin i është refuzuar kërkesa e paditësit për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, fakt ky i cili vërtetohet me vendimi 04/1981/28 i dt.15.10.2019.

Nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura dhe atë që nga dt.01.10.1999, ky fakt vërtetohet nga vërtetimi i dt.26.06.2020 lëshuar nga e paditura.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesepadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësve, e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës së pagave lëshuar nga e paditura, lidhur me lartësinë e pagës bazë në emër të paditësit.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurës duke e kontestuar kërkesepadinë e paditësit vetëm për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoi si të pa bazuara për faktin se bazuar në ligjet në fuqi është një e drejtë e pa mohueshme e cila i takon paditësit, andaj gjykata duke u bazuar ne Kontratën Kolektive Sektoriale të miratuar me dt.11.06.2018, vendosi si në pikën I të dispozitivit sa i përket pagesës së dy pagave bazë në emër të shpërblimit jubilar, ashtu që duke iu referua nenit 17 par.3 nën par.3.2, të kontratës së lartcekur me të cilën parashihet se “Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”, andaj paditësi në këtë rast ka më shumë se 20 vite përvojë të punës.

Bazuar në nenin 17 par.4 Kontratën Kolektive Sektoriale është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që ti paguaj kompensimin për kategorinë e lartcekur.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve dhe atë për përpilimin e padis shumë prej 104.00 euro, për përfaqësim në një seanc shumë prej 135.00 euro dhe në emër të taksës për padi shumë prej 20.00 euro.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-se.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.1013/2019, dt.28.07.2020**

**GJYQTARI**  
Skender Shala

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej **7 ditësh**, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.